



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1705/3 prot.,

Datë: 27.06.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Sireta 2F” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-02040-04-19-2024 me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan ,faza e I-re Njesia Administrative Hotolisht ,Bashkia Librazhd” me fond limit 77600000.0 (shtatëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22-04-2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

**Ankimues:** BOE “Sireta 2F” SHPK me NIPT K51501008J dhe “Lis Konstruksion” SHPK me NIPT K66613407H  
Adresa: Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Librazhd  
Adesa: Sheshi : Gjorg Golemi, Librazhd

Në datën 26.06.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1705/2024 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4260 e BOE “Sireta 2F” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-02040-04-19-2024 me objekt ‘Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Vehcan ,faza e I-re Njesia Administrative Hotolisht, ,Bashkia Librazhd” me fond limit: 77600000.0 (shtatëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22-04-2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues BOE “Sireta 2F” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK.

Bazuar në gjurmën “b”, të pikës 4, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:  
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që BOE “Sireta 2F” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1705/2024 prot., datë 26.06.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4260.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

*I. SKUALIFIKIMIN E BASHKIMIT TE OPERATOREVE EKONOMIKE Shoqëria “SIRETA-2F” SHPK & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” shpk PER SHKAK SE : Nuk kane arritur te deshmojne se plotesojne kriterin 3.8 te kerkuar ne DST si me poshte :*

*3.8.Pajisjet e domosdoshme për kryerjen e këtij investimi duke u nisur nga lloji dhe sasia e volumeve të punimeve dhe afati i punimeve si dhe kushtet në të cilat do të kryhet ky investim, mjetet e kerkuara jane si vijon:*

*Nr Emri i mjetit/pajisjes Njesi Sasi Gjendja*

*1 Kamion veteshkarkues kapaciteti 12 - 20 ton Copë 3 Pronësi ose me qera*

*2 Kamion veteshkarkues kapaciteti mbi 20 ton Copë 6 Pronësi ose me qera*

*3 Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 Ton Copë 2 Pronësi ose me qera*

*4 Asfaltoshtruese Copë 2 Pronësi ose me qera*

*5 Tokmak Copë 1 Pronësi ose me qera*

*6 Autobetoniere Copë 2 Pronësi ose me qera*

*7 Autopompe Betoni Copë 1 Pronësi ose me qera*

*8 Eskavator me goma Cope 1 Pronësi ose me qera*

*9 Eskavator me zinxhire Cope 3 Pronësi ose me qera*

*10 Rrul hekur - hekur Copë 2 Pronësi ose me qera*

*11 Rrul hekur - gome Copë 2 Pronësi ose me qera*

*12 Rrul asfalti me gome Copë 2 Pronësi ose me qera*

*13 Vibratore Copë 2 Pronësi ose me qera*

*14 Grejder cope 1 Pronësi ose me qera*

*15 Freze asfalti Copë 1 Pronësi ose me qera*

*16 Makineri vijejimi Copë 1 Pronësi ose me qera*

*17 Autobitumatrice Copë 1 Pronësi ose me qera*

*18 Autobot uji Copë 1 Pronësi ose me qera*

*19 Buldozier Copë 1 Pronësi ose me qera*

*20 Aparat topogjeodezik me GPS Copë 1 Pronësi ose me qera*

*21 Saldatrice Copë 2 Pronësi ose me qera*

22 Fabrikë asfaltbetoni e pajisur me leje mjedisore, me distancë jo më shumë se 60 km nga objekti që prokurohet ne zbatim te VKM nr 628 date 15.07.2015, ose Fabrike mobile te levizeshme Copë 1 Pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

23 Nyje prodhim Inertesh e pajisur me leje mjedisore te vlefshme Copë 1 Pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

24 Fabrike prodhimi te elementeve te betonit (bordura, pllaka, tombino) e pajisur me leje mjedisore te vlefshme Copë 1 Pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

25 Minieskavator Copë 2 Pronësi ose me qera

26 Minifadrome Copë 2 Pronësi ose me qera

27 Deflektometer per matjen e ngjeshjes se shtresave te rruges Copë 1 Pronësi ose me qera

28 Dampër kantieri Copë 2 Pronësi ose me qera

29 Aparat ngjitje tub PE, PVC Copë 1 Pronësi ose me qera

30 Kontenier – zyre levizese Copë 2 Pronësi ose me qera

31 Kulle ndricimi Copë 1 Pronësi ose me qera

32 Rimorkiator per transport mjetesh te renda Copë 1 Pronësi ose me qera

33 Cekic Hidraulik Copë 2 Pronësi ose me qera

34 Cekic pneumatik Copë 2 Pronësi ose me qera

35 Motogjeneratore Copë 2 Pronësi ose me qera

36 Sharre per prerje tubosh betoni Copë 1 Pronësi ose me qera

37 Prerese hekuri Copë 1 Pronësi ose me qera

38 Kthyesë hekuri Copë 1 Pronësi ose me qera

39 Pompe uji Copë 1 Pronësi ose me qera

- Kokore minimumi 80 copë

- Jeleke fosforeshent 80 cope

- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 4 copë

- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 2 copë

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Konstatimi dhe argumentimi I KVO :

1. Me marreveshjen e bashkepunimit e dates 08.05.2024 ne Nenin 4 Pika 1 Shoqëria “LIS KONSTRUKSION“ shpk, do të kontribuojë në masën 11.19 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë keta zera punimesh:

3- PUNIME PER TRUPIN E RRUGES Zerin: F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm ne sasine 0,4849 ton.

5 - PUNIME RRETHIMI Zerin: F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm ne sasine 0.35 ton

6 - PUNIME PER STRUKTURA,MURE,KANALE Zerin: F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm ne sasine 3.50 ton

7- PUNIME PER TOMBINO Zerin: F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm ne sasine 4.120 ton  
Shoqëria “LIS KONSTRUKSION“ shpk Ne FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT Pika C: DEKLARATË Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të

nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” nuk ka Deklaruar ne Piken 3.8 Makineri /pajisje Prerese hekuri , Kthyses hekuri per domosdoshmerin e realizimin te kontrates. Nisur nga kjo KVO gjykon se Shoqëria “LIS KONSTRUKSION“ shpk nuk permbush % e Marreveshjes se bashkepunimit lidhur me Dates 08.05.2024 pasi nuk disponon mjetet/pajisjet/makinerite e nevojshme per realizimin e punimeve objekt kontrate per punimet te cilat ka marre persiper.

2. Shoqëria “SIRETA 2F” shpk, do të kontribuojë në masën 88.81 % në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë te gjithë zerat e tjere te punimeve sipas preventivit te ofertuar.

Shoqëria “SIRETA 2F” shpk ka marre persiper sipas marrveshjes se Bashkepunimit te Dates 08.05.2024 ne Nenin 4 Pika te gjitha Zerat e Preventivit në masën 88.81 % Shoqëria “SIRETA 2F” shpk nuk disponon stafin e Kualifikuar Konkretisht Zerit 4 - PUNIME PER BORDURE, KUNETE.

1. F V bordura betoni 15x25 cm prej 2 pllakashtrues . nisur nga kjo KVO gjykon se Shoqëria “SIRETA 2F “ shpk nuk permbush % e Marreveshjes e bashkepunimit lidhur me Dates 08.05.2024 KVO gjykon se BASHKIMI I OPERATORVE EKONOMIK Shoqëria ”SIRETA-2F” SHPK & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION ” shpk nuk permbush % e Marreveshjes se bashkepunimit lidhur me Dates 08.05.2024 pasi nuk disponon mjetet/pajisjet/makinerite e nevojshme per realizimin e punimeve objekt kontrate per punimet te cilat ka marre persiper. Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...” Per sa me lart KVO vendos skualifikimin e BASHKIMIT TE OPERATOREVE EKONOMIKE Shoqëria ”SIRETA-2F” SHPK & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” shpk.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 27.06.2024.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**